



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 74-të, të mbajtur më 05.09.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-4602/1 datë 09.11.2021, me pretendime për parregullsi në zbatimin e procedurës administrative, **HIDHET POSHTË**.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë sepse denoncimi nuk përmban pretendime të qarta apo indikacione për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave publike dhe detyrave zyrtare, por përmbajnë pretendime lidhur me veprimet në kuadër të një procedure administrative për të cilat KSHPK-ja nuk ka kompetencë të veprojë.

Lënda me numër 12-4602/1 nga data 09.11.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më datë 09.11.2021, nga një parashtrues i njohur është dorëzuarë denoncim e cila përmban pretendime për parregullsi në zbatimin e procedurës administrative dhe është formuar lënda me numër 12-4602/1, datë 09.11.2021.

Në denoncim, parashtruesi thekson se me Vendim të Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor - Dega /// (Nr./// i /// viti) i është njohur e drejta e pensionit të pleqërisë në masën që ai nuk ka qenë i kënaqur, prandaj në një periudhë të gjatë kohore ka paraqitur ankesa në Komisionin Shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe në procedurën e punësimit të shkallës së dytë, si dhe padi në Gjykatën Administrative. Sipas asaj që thuhet në denoncim, Gjykata Administrative me disa aktvendime e ka vërtetuar kërkesën e tij, por Fondi i Sigurimeve Pensionale dhe Invalidor - dega /// dyshohet se nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës kompetente. Parashtruesi në denoncim ka treguar gjithashtu se në momentin e paraqitjes së kërkesës është në proces para Komisionit Shtetëror për vendimin në procedurën administrative dhe procedurën e

marrēdhēnies sē punēs nē shkallēn e dytē pēr rezultatin e tē cilit nē momentin e paraqitjes sē kērkesēs ai nuk kishte njohuri.

Pas shqyrtimit tē pretendimeve nē fjalē, KSHPK-ja arriti nē pērfundimin se ato nuk nēnkuptojnē akte korrupsioni nē pērputhje me pērkufizimin e pērcaktuar nē Ligjin pēr Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit tē Interesit, pas sē cilēs vlerēsoi se nuk ka pretendime apo indikacione tē qarta pēr veprime tē paligjshme ose tē palejueshme tē zyrtarēve nē kryerjen e detyrave publike, kompetencave dhe detyrēs zyrtare, por pērmban pretendime lidhur me veprimet nē kuadēr tē njē procedure administrative pēr tē cilat KSHPK-ja nuk ka kompetencē tē veprojē.

Nē bazē tē theksuarēs, KSHPK-ja vendosi si nē dispozitēn e kētij vendimi.

Pērgatiti: A.R.M
Miratoi: SPD, Anētar i KSHPK-sē

КОМИСИОНИ СШТЕТЃОРОРЃ
ПЃР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
КРЈЕТАРЕ,
Biljana Ivanovska

